



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 159

Tiranë – E premte, 8 tetor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 8.10.2021	Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike..... 14829
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 375/2, datë 4.10.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633 datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar..... 14829



VENDIM
Nr. 584, datë 8.10.2021

**PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË
EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME
ENERGJI ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

2. Ngritjen e grupit ndërinstitucional për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, që drejtohet nga zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrin e Financave dhe Ekonomisë dhe çdo përfaqësues nga institucione të tjera, që vlerësohen të nevojshëm nga zëvendëskryeministri.

3. Shoqëritë “KESH” sh.a., “OST” sh.a. dhe “OSHEE Group” sh.a., të pezullojnë planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Këto shoqëri të koordinojnë ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me udhëzimet e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike.

4. Ngarkohet ministri i Financave dhe Ekonomisë që të sigurojë mekanizmat e duhur financiarë, me qëllim mundësimin e importit të energjisë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë të energjisë elektrike.

5. Gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike i shtrën efektet deri më 15 prill 2022.

6. Ngarkohen zëvendëskryeministri, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Financave

dhe Ekonomisë, “KESH” sh.a., “OST”, sh.a. dhe “OSHEE Group” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 375/2, datë 4.10.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 633 DATË 17.11.2020, “PËR
NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË
VENDE TË MBYLLURA APO TË
HAPURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3926, prot., datë 22.9.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri më datë 4.10.2021”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri më datë 18.10.2021”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**
Ogerta Manastirliu

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vëlosur me anë

Formati 61x86/8

të një procedure automatike nga një sistem elektronik.

(Qendra e Botimeve Zyrtare) Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 16 lekë